

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-29/12

Prishtinë  
1 nëntor 2012

Në çështjen juridike të

**M.J.1**

*Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi*

përfaqësuar nga

**S.J**

kundër

**RR.S**

*Pala përgjegjëse/Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filchave - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/120/2011 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA06212, KPA06213, KPA06214, KPA06217 dhe KPA06221), i datës 07 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 1 nëntor 2012, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1- Ankesat e paraqitura nga S.J me datë 21 dhjetor 2011 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-29/12, GSK-KPA-A-30/12, GSK-KPA-A-31/12, GSK-KPA-A-32/12 dhe GSK-KPA-A-33/12, janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-29/12.
- 2- Ankesat e paraqitura nga S.J me datë 23 janar 2012, hedhen si të palejueshme për shkak të paraqitjes jashtë afatit kohor.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 29 dhjetor 2006, S.J ka paraqitur 5 (pesë) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), në emër të titullarit të së drejtës pronësore sipas autorizimit të M.J.1 duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë në disa ngastra dhe ri-posedimin e tyre. Ajo ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale kanë qenë në emër të këtij bartësi të së drejtës pronësore dhe të cilat ishin uzurpuar dhe si datë hubmjes e thekson datën 07 qershor 1999, duke theksuar se të drejtat pronësore janë humbur për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1998/1999.

Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Leternjoftimin, të lëshuar me datë 01 qershor 2006 nga Komuna e Podujevës, Republika e Serbisë;
- Fletën Poseduese nr. 44, lëshuar me datë 08 shtator 2007 nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronës e Komunës së Podujevës (UNMIK);
- Fleta Poseduese nr. 44, lëshuar me datë 08 shtator 2004 nga Enti Republikan i Gjeodezisë-Drejtoria e Komunale Kadastrale e Komunës së Podujevës;
- Autorizimin e S.J, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Krushevac Vr.nr....., i .....

Fleta Poseduese nr. 44, konstaton se M.J.1 është pronar i këtyre ngastrave të kërkuara në Komunën e Podujevës, Zona Kadastrale Batlavë, si në vijim:

Numri i ankesës dhe numri i lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-29/12 (KPA06212)	Ngastra nr. 873, në vendin e quajtur “Statovci-Gruda”, pemishte e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 00. 22. 70 ha
GSK-KPA-A-30/12 (KPA06213)	Ngastra nr. 870, në vendin e quajtur “Statovci-Gruda”, livadh e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 00. 22. 04 ha
GSK-KPA-A-31/11 (KPA6214)	Ngastra nr. 867, në vendin e quajtur “Statovci-Gruda”, arë e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 02. 31. 02 ha
GSK-KPA-A-32/12 (KPA06217)	Ngastra nr. 868, në vendin e quajtur “Statovci-Gruda”, pemishte e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 79. 36 ha
GSK-KPA-A-33/12 (KPA06221)	Ngastra nr. 869, në vendin e quajtur “Statovci-Gruda”, arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0. 90. 18 ha

Lidhur me kërkesat e regjistruara në Agjensinë Kosovara të Pronës me numrat KPA06212, KPA06213, KPA06214, KPA06217 dhe KPA06221, të datës 29 dhjetor 2006, ekipi i AKP-së për njoftim me datë 20 dhe 27 qershor 2011 ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregonin se pronat ishin objekt kontesti të kërkesave dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqisnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve.

Pala përgjegjëse në kërkesë me datë 04 nëntor 2011, ka dhënë përgjigjen, duke pretenduar se ngastrat kadastrale të kërkuara i ka blerë nga bartësi i të drejtës pronësore që në vitin 1972, ndërsa pjesën tjetër të këtyre ngastrave i ka blerë djali i tijë H.S, duke paraqitur në vijim këto dokumente:

- Kontratën paraprake të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Podujevë Vr.nr.68/72, të datës 03 mars 1972. Me këtë kontratë konstatohet se shitësi M.J.1 i ka shitur RR.S nga Batllava, në cilësinë e palës përgjegjëse tokë në sipërfaqe prej dy hektarësh që gjenden në Zonën Kadastrale të Podujevës. Me këtë kontratë po ashtu konstatohet se shitësi ia ka dorëzuar blerësit sipërfaqen e theksuar në pronësi dhe posedim;
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.51/72, i datës 11 dhjetor 1972, konstaton se është refuzuar kërkesëpadia e R.J nga Batllava, me të cilën ka kërkuar që në mes tjerash i padituri RR.S t’ia pranojë të drejtën e pronësisë duke ia kthyer në posedim pjesën e ngastrës kadastrale nr. 868, 869, 870, 871dhe 873, me kulturë livadh, pemishte dhe arë në vendin e quajtur “Statovci –Gruda”, në sipërfaqe prej 2.14.00 ha, me arsyetimin se nuk është kontestuese se në vitin 1970 R.J dhe bijtë e sajë M.J.2 dhe M.J.1 në mes vetes e kanë ndarë paluajshmërinë në sipërfaqe prej 9.08.07 ha, e cila evedentohet sipas Fletës Poseduese nr. 41, të Zonës Kadastrale Batlavë. R.J i ka takuar ara në sipërfaqe prej 0.70.00 ha dhe 0.50.00 mal, ndërkaq M.J.2 dhe M.J.1, secilit prej tyre iu ka takuar sipërfaqja prej 2.14.00 ha. M.J.2 pjesën e vet në sipërfaqe prej 2.14.00 ha ia ka shitur në vitin 1971 RR.S dhe se kjo shitblerje ka qenë juridikisht e vlefshme, ngase është bërë me kontratë juridikisht të vlefshme gjë edhe ky blerës ka fituar pronësinë, ndonëse këto ndryshime nuk janë evidentuar në librat kadastrale. Në paragrafin i dytë të këtij aktgjykimi është vendosur se i është pranuar kërkesëpadia paditëses R.J dhe është detyruar i padituri - tani paraqitësi i kërkesës M.J.1 që asaj t’ia pranojë të drejtën e pronësisë duke ia kthyer në posedim pjesët e ngastrave kadastrale nr. 868, 869, 870, 871dhe 873 me kulturë livadh, pemishte dhe arë në vendin e quajtur “Statovci- Gruda”, në sipërfaqe prej 2.14.00 ha, si dhe disa ngastra tjera që nuk janë objekt i kërkesës. Kjo ngase i padituri M.J.1 ka pranuar kërkesëpadinë e nënës së tij R.J, me ç’rast ajo është titullare e të drejtës së pronësisë së pjesës së këtyre pronave të paluajtshme. Edhe këto ndryshime nuk janë evidentuar në të dhënat kadastrale.
- Me procesverbalin e seancës kryesore C.nr 6/1975, i datës 03 shkurt 1975, konstatohet se paditsja R.J, nga Batllava, ka hequr dorë nga padia e paraqitur kundër kundër M.J.1, me arsyetim se lidhur me këtë çështje juridiko pronësore është vendosur me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr51/72, dhe
- Letërnjoftimin e palës përgjegjëse RR.S, të lëshuar nga UNMIK-u me datë 23 shtator 2008.

Të dyja edhe kontrata paraprake e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Podujevë Vr.nr.68/72, e datës 3 mars 1972, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.51/72, i datës 11dhjetor 1972, është verifikuar pozitivisht nga Ekipi Verifikues i AKP-ës.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KKPK/D/A/120/2011, i datës 07 shtator 2011, ka refuzuar kërkesat në lidhje me palujtshmëritë e kërkuara, me arsyetimin se paraqitësi i kërkesave i ka konfirmuar pretendimet e palës përgjegjëse, se ajo ia ka shitur atij ato vullnetarisht në vitin 1972 dhe nuk ka dhënë shpjegime dhe sqarime lidhur me pohimin se e ka humbur pronën si pasojë e konfliktit si dhe ka refuzuar të marr pjesë në procedurë apo të ofrojë prova përkatëse. Pra, për rrjedhojë, paraqitja e kërkesave ka dështuar për të dëshmuar të drejtën pronësore të tanishme në pronat e kërkuara.

Ky vendim i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me datë 21 dhjetor 2011, ndërkaq që ajo ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme me 23 Janar 2012. Ankesa e ka atakuar vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe procedural, duke propozuar prishjen e vendimit dhe vërtetimin e të drejtës së saj pronësore dhe duke i dhënë asaj riposedimin e asaj prone ose anulimin e këtij vendimi dhe kthimin e lëndës në rivendosje. Me këtë ankesë ankuesja pretendon se përfundimi ligjor i KKPK-ës kur e ka refuzuar kërkesën e saj është i gabuar, për shkak se ajo nuk ishte thirr nga KKPK-ja për to deklaruar në lidhje me kërkesat e saja të parashtruara, duke propozuar gjithashtu dëshmi relevante dhe se nuk është bërë asnjë bisedë telefonike me Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-ës me datë 02 gusht 2012 dhe se kontrata e shitjes së palujtshmërisë Vr.nr.68/72, e datës 3 mars 1972 ishte jo valide, për shkak se ajo nuk ishte shitur nga pronari i saj dhe që sipas fletës poseduese nr. 44, Zona Kadastrale e Batllavës ai është M.J.1 nga Batllava, të cilin ajo e përfaqëson sipas autorizimit.

Me 02 dhjetor vendimi KKPK i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë – palës përgjegjëse në ankesë, ndërsa që ankesa i është dorëzuar atij me 29 shkurt 2012. Ai nuk ka paraqitur ndonjë ankim ose ndonjë përgjigje në ankesë.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

#### **Arsyetim ligjor:**

#### **Bashkimi i ankesave:**

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky

nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 15 (pesëbëdhjetë) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-29/12 deri GSK-KPA-A-33/12 , janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-29/12.

### **Pranueshmëria e ankesave:**

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin animor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-ës, dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe thënjeve ankimore gjeti se:

Ankesat janë të papranueshme ngase janë paraqitur jashtë afatit ligjor sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e njoftimit të palëve për vendimin. Kjo për arsye se vendimi i është dorëzuar ankuesit me 21 dhjetor 2011 dhe se ajo me 23 janar 2012 ka ushtruar ankesë. Data 20 janar 2011 ( e premte) është dita e fundit në të cilën është dashur të paraqitet ankesa, por e njëjta është ushtruar me datë 23 janar 2012, që d.m.th me tre ditë vonesë. Prandaj, meqë ankesa është e paraqitur jashtë afatit ligjor, në përputhshmëri me nenin 196 të LPK-ës hedhet si e paafatshme.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.15 dhe 10.21 të UA 2008/2) që nuk mund të jetë më shumë se € 30).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 90 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 30 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*